

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Kisha hajdutë në shtëpi, u tremba dhe qëllova" - Vrasja e shqiptarit që hyri të vidhte një banesë në Itali, publikohet telefonata e pronarit me policinë
ADRESA	https://www.gazetatema.net/bota/kisha-hajdute-ne-shtepi-u-tremba-dhe-qellova-vrasja-e-shqiptarit-qe-hyri-te-i588003
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	redirected

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 20:15:43 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 20:35:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0767d3d9ef955dc5b2ff0122a40124712b539a0c3fbbcc117493ef54f4ade2e6
TEKSTI	1be3f4f695a2334f2091c7c8b20790af4038e7628f22ad731e1d98bcc43397ff
PAMJA	6db177747a43c870c68d6d821358b37b2b5a4a2c5c93bb4965543059b65d1234

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	47733c8cca7a812eabdaccda7a171b32604edd5f3363d1a5327e782f89ef238a
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	55f810520a93a3fb0649992dafdc0630325acd6490d1af12697ee3ba7602edf3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/47733c8cca7a812eabdaccda7a171b32604edd5f3363d1a5327e782f89ef238a>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



40 vjet pas Çernobilit, Senati italian i jep dritën jeshule ligjit të ri për energjinë bërthamorePlagosje me thike prane "Petro Nimit" në TiranëIluzioni i produktivitetit të inteligjencës

“Kisha hajdutë në shtëpi, u tremba dhe qëllova” - Vrasja e shqiptarit që hyri të vidhte një banesë në Itali, publikohet telefonata e pronarit me policinë



23 Shtator 2026, 22:35Bota TEMA



“Mirëmbërë, jam Roberto Mollo. Kam pasur hajdutë në shtëpi, unë u mbrojta... njëri ka vdekur”. Këto janë fjalët e para të telefonatës që një 35-vjeçar nga Baldissero d’Alba, në provincën e Cuneos në Itali, bëri në numrin e emergjencës 112, pasi qëlloi ndaj një grupi grabitësish që tentuan të hynin në banesën e tij.

Ngjarja ndodhi në orët e para të mëngjesit të së dielës, 20 shtator. Sipas hetimeve, Roberto Mollo, i cili punon si shofer kamioni, ka qëlluar 13 herë me armë zjarri ndaj personave që po tentonin një vjedhje në një shtëpi në rikonstrukcion ku ai jetonte.

Një prej plumbave goditi 36-vjeçarin Gjovalin Lasri, i cili humbi jetën.

Telefonata e Mollo-s me 112 është bërë publike nga “Tg1”, ku dëgjohet ai duke i shpjeguar operatorit situatën.

“Kam pasur frikë, jam i dëshpëruar. Po më silleshin nëpër shtëpi”, dëgjohet të thotë ai.

Më pas komunikimi kalon te karabinierët, të cilëve 35-vjeçari u thotë se ishte i armatosur dhe se kishte reaguar për t’u mbrojtur.

“Unë jam i armatosur, u mbrojta. Tani është një person në tokë, nuk e di nëse ka vdekur”, u shpreh ai.

Kur u pyet nëse kishte qëlluar me armë, Mollo u përgjigj: “Po, i qëllova”.

“Ky person ishte i maskuar, ishte jashtë në oborr. E mbylla derën, por u tremba dhe qëllova”, shtoi ai.

Sipas autoriteteve italiane, 36-vjeçari Gjovalin Lasri u gjet pranë daljes së oborrit të banesës. Ai kishte veshur një kapuç, doreza dhe mbante një elektrik dore.

Gjatë kontrollit, në xhepat e tij u gjet edhe një kaçavidë, ndërsa kishte me vete rreth 2 mijë euro. Hetuesit po verifikojnë nëse paratë mund të lidhen me grabitje të tjera, shkruan [Corriere](#).

Sipas dëshimeve të para, arrihet në konkludime se Lasri mund të ketë qenë pjesë e një bande “grabitësish në lëvizje” të cilët udhëtojnë në zona

të ndryshme dhe kryejnë disa vjedhje brenda së njëjtës natë.

Hetimet vijojnë për të zbardhur plotësisht dinamikën e ngjarjes, ndërsa autoritetet po përpiqen të identifikojnë edhe personat e tjerë që dyshohet se kanë qenë pjesë e grupit.

 Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

22:05 Bota

[Trump zbulon marrëveshje aksionesh me vlerë miliona dollarë në industrinë e teknologjisë dhe AI - Euronews Albania](#)

21:55 Bota

[Zelensky flet në OKB: Moska ka pësuar humbje poshtëruese! Vetëm një njeri dëshiron luftë në Ukrainë](#)

20:45 Bota / 3 komente

Presidenti i Argjentinës sulmon ashpër OKB-në gjatë Asamblesë: Organizatë e padobishme që ushqen burokratë

19:15 Bota / 5 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.